



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201401968/3

Tiranë ___/___/2014

Lënda : *Rekomandohet nxjerrja e aktit për konstatimin absolutisht të pavlefshëm të Urdhërit nr.2252 Prot, datë 31.10.2014, sipas të cilit është vendosur për prishjen e objektit pronë e shtetasve A. dhe A.Z.*

Drejtuar : **Kryetarit të Bashkisë,**
Z.Baftjar Zeqaj

FIER

Z.Kryetar!

Institucioni i Avokatit të Popullit ka pranuar për shqyrtim ankesën e paraqitur nga shtetasi A.Z., banor i Qytetit Fier, në të cilën është prezantuar shqetësimi për shkeljen e parimit të sansionuar në nenin 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, në procesin e nisur për shpronësimin e pasurisë së tij të paluajtshme, rregjistruar me numër 6/113 N1, Zona Kadastrale 8532, Volumi 35, Faqe 19, në rregjistrin e Zyrës Vendore të Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Fier.

Referuar akteve të vëna në dispozicion prej ankuesit, rezulton se, më datë 30.10.2014, është njoftuar ankuesi për aktin e nxjerr prej jush nr.2252, date 31.10.2014, sipas të cilit është urdhëruar, për ;

"Prishjen e objektit të ndërtuar nga qytetari A dhe A.Z."

Nxjerrja e aktit, Urdhërit nr. 2252 Prot, datë 31.10.2014, sikurse konstatohet, është kryer në kundërshtim me procedurën e parashikuar në ligjin nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", dhe si i tillë, në kuptim dhe zbatim të nenit 115/a dhe 116/c të Kodit të Procedurës Administrative, klasifikohet si akt absolutisht i pavlefshëm.

Duhet kuptuar gjithashtu se, Këshilli Bashkiak, Fier, në kundërshtim me kompetencat e parashikuara në Ligjin Nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", ka vendosur midis të tjerave me Vendimin nr.76, date 30.10.2014, për ;

“Miratimin e shpronësimit të objekteve pronë private që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksion i Bulevardit “Jakov Xoxa”, sipas relacionit të ekzekutivit”.

Ky Vendim i Këshillit Bashkiak, Fier, është nxjerr në kapërcim të kompetencave të tij ligjore, dhe si i tillë klasifikohet sipas parashikimit të nenit 116/b të Kodit të Procedurës Administrative, si akt administrativ i absolutisht i pavlefshëm

Referuar parashikimeve të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 *“Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”*, Këshillit Bashkiak, Fier, në procesin e shpronësimit të pasurisë pronë private, të iniciuar prej Bashkisë, Fier, ka të drejtë të marr vendime për miratimin ose jo të kërkesës së Kryetarit të Bashkisë, Fier, për fillimin e procedurave të shpronësimit dhe paraqitjes së dokumentacionit përkatës pranë ministrisë kompetente për vazhdimin e mëtejshëm të procedurave administrative të shpronësimit, të cilat përfundojnë me nxjerrjen e vendimit përkatës prej Këshillit të Ministrave, për shpronësimin e pasurive pronë private. Pra, nuk është organ i Këshillit Bashkiak, Fier, i cili ka tagrin të vendos për miratimin e shpronësimit të objekteve, pronë private që preken nga realizimi i një projektit vendor në shërbim dhe interes të publikut.

Z.Kryetar!

Ligji nr.8561, datë 22.12.1999 *“Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”*, në nenin 5/1 të tij parashikon se ;

“Kur realizimi ose mbrojtja e interesave publike nuk mund të arrihet pa ushtruar të drejtat e pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme ose të luajtshme pronë private, Këshilli i Ministrave, mbi kërkesën e subjektit kërkuar në favor të të cilit bëhet shpronësimi, me propozim të ministrit kompetent sipas këtij ligji, vendos shpronësimin e këtyre pasurive”.

Pra, në kapërcim të kompetencave të parashikuara në ligj, si dhe në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë të sanksionuar në nenin 9/1 të Kodit të Procedurës Administrative, se;

“Organet e Administratës Publike e zhvillojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë aderon, ligjet e Republikës së Shqipërisë, Brenda kufijve të kompetencave që u janë dhënë atyre dhe konform qëllimit për të cilat janë dhënë këto kompetenca”,

Këshilli Bashkiak, Fier, ka proceduar me nxjerrjen e aktit absolutisht të pavlefshëm, Vendimit nr.76, datë 30.10.2014.

Këshillit Bashkiak, Fier, me rastin e fillimit të procedurave të shpronësimit nga ana e Bashkisë, Fier, i takon të shprehet vetëm për miratimin ose jo të kësaj procedure. Më tej, me rastin e miratimit të procedurës së nisur për shpronësim, i takon Bashkisë, Fier, që në zbatim të parashikimit të kryer në nenin 10 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 *“Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”*, të depozitohet pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, kërkesën dhe dokumentet shoqëruese të kërkesës për shpronësim, sikundër parashikuara në këtë dispozitë ligjore. Kjo procedurë referuar situatës së prezantuar rezulton e pakryer nga ana e Bashkisë, Fier. Procedura e mëtejshme e shpronësimit në referim të nenit 11, vijon me kryerjen e vlerësimit të pasurisë objekt shpronësimi, prej Ministrisë së Punëve të Brendshme, njoftimin me shkrim të pronarëve, prona e të cilëve preket për interesa

publike, sipas formularit standart, publikimin e kërkesës për shpronësim në fletoren zyrtare dhe organet e medias. Me rastin e kryerjes së kësaj procedure dhe kalimit të afatit ligjor brenda të cilit mund të kryhet ankimi prej pronarëve të pasurive objekt shpronësimi, Ministria e Punëve të Brendshme përcjell praktikën për vijimin e procedurave të mëtejshme pranë Këshillit të Ministrave, i cili në refzim të nenit 21 të ligjit në fjalë, vendos për shpronësimin në rastet kur propozimi për shpronësim gjendet i bazuar në ligj dhe në fakt. Vetëm pas daljes së vendimit për shpronësim nga ana e Këshillit të Ministrave, si dhe vënies në dispozicion të vlerës së shpronësimit, procedohet për pishjen e objekteve të shpronësuaradhe marrjen në pronësi të truallit apo tokës për ndërtimin e objekteve publike. në kundërshtim me këtë procedure të parashikuar në ligj, ju z.Kryetar, keni proceduar me nxjerrjen e aktit absolutisht të pavlefshëm, Urdhërit nr. 2252 Prot, date 31.10.2014, *“Për prishjen e objekteve që preken nga realizimi i projektit me objekt “Rikonstruksion i Bulevardit “Jakov Xoxa””, në zbatim të Vendimit nr.76, datë 30.10.2014, të Këshillit Bashkiak, Fier. Kjo procedure e kryer nga ana e organit që ju përfaqësoni, vlerësohet në kundërshtim më parimin e sanksionuar në nenin 42/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, se; “Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cënohen pa një proces të rregullt ligjor”.*

Të njohësh dhe të trajtosh pronarët sipas të drejtave të tyre është një detyrim kushtetues

Ligji nr.8561, datë 22.12.1999 *“Për Shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, në nenin 3 të tij, parashikon se ;*

“Shpronësimi dhe marrja në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private realizohet në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara në këtë ligj, duke garantuar transparencën, barazinë e shtetasve dhe mbrojtjen e interesave dhe të drejtave të tyre pasurore”.

Ashtu dhe siç u shprehëm më sipër, duhet theksuar se kryerja e veprave të tilla publike në favor të komunitetit, që gjithsesi janë për tu vlerësuar dhe mbështetur, duhet të ecin paralelisht me zbatimin korrekt të ligjit në mbrojtje të të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit.

Në të tilla kushte Avokati i Popullit apelon për më shumë kujdes dhe profesionalizëm në marrëdhënie me individët dhe me të drejtat që ata gëzojnë, karshi organeve të administratës publike.

Në ushtrim të detyrës së tij, se ;

“Avokati i Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të individit nga veprimet dhe mosveprimet e organeve të administratës publike, si dhe të tretëve që veprojnë për llogari të tij”, duke e konsideruar praktikën e lartpërmendur si shkelje të të drejtave dhe interesave të ligjshme të z. Zahoaliaj, mbi bazë të parashikimit të nenit 63 pika 3 të Kushtetutës së Shqipërisë, në të cilën sanksionohet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike” si dhe në bazë të nenit 21 gërma “b” të ligjit Nr.8454 dt.4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, në të cilin parashikohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”;

REKOMANDOJMË

Nxjerrjen e aktit për konstatimin absolutisht të pavlefshëm të Urdhërit Nr.2252 Prot, datë 31.10.2014, sipas të cilit është vendosur për prishjen e objektit pronë e shtetasve A. dhe A.Z.

Kthimi i përgjigjes të kryhet në afatin e parashikuar në nenin 22, të Ligjit Nr.8454, datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i cili parashikon se:

“Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, kërkesë apo propozim për shkarkim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin, kërkesën apo propozimin për shkarkim dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit, kërkesës apo propozimit për shkarkim.

Përgjigja duhet të përmbajë shpjegime të arsyetuara për çështjen në fjalë, si dhe çfarë veprimesh, mosveprimesh apo masash ka ndërmarrë ai organ”,

Me besim në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Etilda GJONAJ (SALIU)